



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 92
Prishtinë, më 08.11.2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Ganimete Musliu, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Rasim Demiri dhe Danush Ademi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha-OSBE; Dragana Dukie-KTK 2; Leotrim Gërmizaj-YOUTH CAUCUS; Gurjeta Zeka-Kuvendi i Kosovës; Andon Bresnica-Kosovalive; Rrezarta Zekaj-RTK; Marie Nikolla-RrokumTV; Amire Qamili-Kosova press.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Hana Bajraktari.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 01.10.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rexhep Selimi – Propozoi shtimin e një pike të rendit të ditës për trajtimin dhe vlerësimin e situatës së Sigurisë pas zgjedhjeve të 3 nëntorit në veriun e Mitrovicës.

Fatmir Xhelili – Propozoi heqjen nga rendi i ditës shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe vënien në rend dite lidhur me situatën e sigurisë, pas zgjedhjeve të 3 nëntorit, por pa hyrë në analiza shtesë.

Lidhur me këtë çështje, propozoi kërkimin e informacioneve nga EULEX-i dhe Policia e Kosovës, ndërsa diskutimi të jetë në bazë të informacioneve. Më tutje, shtoi se si Komision, por edhe qytetarët kanë nevojë të dinë se a ka pasur EULEX-i plan operativ për ditën e zgjedhjeve dhe pse nuk është zbatuar ai, pasi që edhe vetë administratorja e përkohshme e asaj pjese, ka deklaruar se EULEX-i nuk ka ndërmarrë asnjë masë shtesë dhe kanë qenë veprime si të ditëve të zakonshme, edhe pse ka qenë një ditë e rëndësishme për Kosovën dhe pjesën veriore.

Duke kërkuar që kjo çështje të diskutohet në mbledhjen e radhës së Komisionit, bazuar në informacionet shtesë, u shpreh i kënaqur me pjesëmarrjen e qytetarëve serbë në zgjedhje, duke thënë se ky është një hap i mirë drejt integritetit të tyre në institucionet e Kosovës. Ai gjithashtu tha se veprimet e rrjedhave kriminale-politike janë të dirigjuara nga dikush tjetër për të bërë pengesë.

Rexhep Selimi – Theksoi se, pasi zgjedhjet tjera në këto vende do të jenë më 17 nëntor, Komisioni nuk mund të humbë kohë me analiza, sepse nuk ka se kujt t'i referohet, duke kërkuar kështu që qëndrimi i Komisionit të jetë publik.

Kryetari i Komisionit – U pajtua me ndryshimet e propozuara për heqjen nga rendi i ditës, shqyrtimin e Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, për shkak të moszhvillimit të saj si pikë e rendit të ditës në seancën e së enjtes, si dhe propozimin e z.Selimi për futjen në rend dite të pikës: Qëndrimi i Komisionit rreth situatës në veri, pas zgjedhjeve të 3 nëntorit, për kërkimin e informatave nga EULEX-i dhe Policia e Kosovës rreth veprimeve të tyre që kanë qenë dhe do të jenë, meqenëse këto zgjedhje në këto vende do të përsëriten me 17 nëntor.

Duke konsideruar se është dashur të ndërmerren masa më adekuate nga ana e Policisë së Kosovës, EULEX-it, Prokurorisë dhe gjitha organeve të cilat e kanë për detyrë përcjelljen e mbarëvajtjes së procesit zgjedhor në nivel të Kosovës, Ahmeti tha se demolomi në 3 qendra të votimit në pjesën veriore të Mitrovicës dhe mosvajtja ashtu si duhet e procesit zgjedhor në këtë pjesë, përkundër imazhit të mirë që ka krijuar Kosova me këto zgjedhje të lira dhe demokratike, në veriun Kosovës ka pasur veprime demoluese nga ana e grupeve të caktuara ekstremiste. Ai tha se kjo situatë është krijuar për arsye se Serbia ka favorizuar vetëm një parti politike në atë pjesë, gjë që ka nxitur ndërprerjen dhe demolimin e zgjedhjeve në atë pjesë të Kosovës.

Gjithashtu, ai theksoi se Komisioni kërkon nga organet e sigurisë që zgjedhjet e 17 nëntorit, të jenë të përgatitura, në mënyrë që procesi zgjedhor të shkojë sipas rrjedhave normale të parashikuara, sipas Komisionit Qendror Zgjedhor, të mbikëqyrura nga OSBE-ja, e cila ka marrë përsipër mbikëqyrjen, duke kërkuar kështu zhvillim normal të zgjedhjeve në veriun Kosovës, që Kosova në tërësinë e vet të ketë krijim të institucioneve të rregullta, në bazë të votës së lirë dhe funksionim normal të shtetit të Republikës së Kosovës.

Rexhep Selimi – Tha se situata e krijuar në veri rreth zgjedhjeve, ka dëmtuar procesin zgjedhor, i cili përgjithësisht, sa i përket sektorit të sigurisë, ka qenë ndër më të rregulltit deri më tani, përveç veriut të Kosovës, ku sipas tij, do të duhej të ishte e pritshme. Ai tha se organet e sigurisë do të duhej të ishin të përgatitura, kjo për shkak se është paralajmëruar një gjë tillë.

Selimi vlerësoi se përgatitjet dhe pritshmëritë e tilla nuk janë përcjellë në mënyrë adekuate, grupet e maskuara kanë arritur t'i prishin këto vendvotime dhe procesin e votimeve në pikat më delikate të kësaj hapësire, dhe si rrjedhojë e kësaj, ka përsëritje të zgjedhjeve.

Ai më tutje theksoi se ndërhyrja e këtyre mekanizmave, të mbështetur nga degët e institucioneve jashtë Kosovës, kanë arritur që ta dëmtojnë procesin zgjedhor deri në këtë shkallë. Gjithashtu, sipas tij, bashkëpunimi i strukturave të sigurisë vendore dhe ndërkombëtare, nuk ka qenë i mjaftueshëm dhe strukturat e sigurisë ndërkombëtare, në këtë rast EULEX-i, nuk e ka marrë seriozisht çështjen e sigurisë atje.

Nisur nga paralajmërimet për prishje të serishme të votimeve në veri, Selimi tha se institucionet dhe strukturat e sigurisë së Kosovës do të duhej ta marrin shumë më seriozisht sigurinë, për shkak të rrethanave të krijuara. Sipas tij, institucionet e sigurisë së Kosovës duhet të jenë më të përgatitura dhe efektive në mbrojtje dhe siguri gjatë votimeve, duke shtuar se kjo gjë ka munguar, sepse njerëzit nuk kanë pasur mundësi që të votojnë lirshëm. Ai gjithashtu theksoi nuk ka pasur kufizim etnik të lirisë së votimit, sepse as shqiptarët, as serbët, e as boshnjakët dhe komunitetet tjera joshqiptare, nuk kanë pasur mundësi të votojnë lirshëm.

Duke theksuar detyrën e institucioneve dhe të Qeverisë së Kosovës për mundësimin e lirisë së votës për të gjithë qytetarët e Kosovës, Selimi rekomandoi që nga ana e Komisionit, t'iu bëhet thirrje institucioneve qeveritare dhe të sigurisë së Kosovës, që për shkak të përsëritjes së zgjedhjeve në veri, të krijohet një ambienti i sigurt i votimit. Ai tha se Policia e Kosovës do të duhej të merrte përgjegjësinë vet, për të krijuar një rend dhe mundësi të votimit të lirë, sepse siç u shpreh ai, Policia e Kosovës ka kapacitet e duhura dhe në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar, do të mundësonin që atje të votohet lirshëm.

Në zgjedhjet e fundit, ky bashkëpunim ka munguar, sidomos me KFOR-in, por megjithatë institucionet e sigurisë dhe qeverisjes së Kosovës, kanë kapacitete dhe mundësi, ndërsa është detyrë e tyre që të ofrojnë një ambient të mirë atje. Më tutje theksoi se vlerësimi i Komisionit në fushën e sigurisë do të duhej të ishte profesional dhe rekomandimet e dala të jenë të rekomanduara si Komision për Siguri, duke potencuar se vlerësimet politike mund të jenë të ndryshme për këtë, por si anëtar i Komisionit për Siguri, ai ka ftuar Qeverinë, institucionet dhe Policinë e Kosovës, që të marrë përsipër situatën, për shkak se vetëm Policia e Kosovës mund të garantonte më së miri rend dhe ligj atje, sepse sipas tij, e ka për detyrë dhe ka kapacitetet e duhura.

Vjollca Krasniqi – Shprehu mendimin se zgjedhjet e 3 nëntorit kanë qenë zgjedhjet më të mira, më të lira dhe më demokratike në tërë territorin e Kosovës, përveç veriut të Kosovës, ku siç tha ajo, është vërejtur dukshëm një gjë e tillë. Ajo theksoi se një gjë e tillë ka qenë e pritshme, duke u nisur nga fakti se situata në veri, përgjithësisht është e brishtë, e aq më tepër në një proces ku një grup radikalësh ekstremistë kanë arritur të dirigjojnë këtë proces, duke bërë kështu dështimin

e organizimit të këtyre zgjedhjeve. Duke potencuar ndëshkimin e sektorëve të sigurisë vendore dhe ndërkombëtare për dështimin e këtyre zgjedhjeve.

Ajo bëri thirrje që ky proces, më 17 nëntor të jetë më i lirë dhe më i organizuar, në mënyrë që qytetarët të shkojnë lirshëm në qendra të votimit dhe të japin votën e tyre të lirë. Ajo gjithashtu potencoi se përgatitjet e zgjedhjeve të 3 nëntorit kanë qenë jo të duhura dhe pa seriozitetin e duhur nga ana e organeve që bëjnë përcjelljen e këtij procesi, në aspektin të sigurisë.

Fatmir Xhelili – Tha se para kualifikimit të këtyre zgjedhjeve si dështim apo mospasë, është premtues fakti që qytetarët serbë kanë dalë në zgjedhje dhe kanë premtuar numër më të madh të daljes në zgjedhje në të ardhmen. Kjo është shumë premtuese për krijimin e një ambienti më të mirë, që në të ardhmen, serbët e veriut të integrohen në institucionet e Kosovës.

Sipas tij, ka qenë e pritshme se mund të ndodhin incidente, por nisur nga fakti se pjesëmarrja e një numri kaq të madh në zgjedhje, ka qenë i papritur edhe për vet EULEX-in. Kjo mund të jetë arsyeja e neglizhimit të situatës, u shpreh ai.

Më tutje, theksoi se nuk fajëson institucionet e Kosovës dhe Policinë për dështimin e këtyre zgjedhjeve, sepse siç u shpreh ai, Policia e Kosovës ka marrë masat e parapara, por i ka munguar parashikimi dhe veprimi me kohë, megjithatë edhe në shtetet më të organizuara mund të ndodhin parregullsia dhe incidente të tilla.

Duhet konsideruar se gjenerator i këtyre incidenteve janë segmentet e dirigjuara nga Beogradi, dhe nga të dhënat e mjeteve të informimit, thuhet se në ditën e zgjedhjeve janë vërejtur pjesëtarë të xhandarmërisë serbe dhe njerëz të komponentëve të sigurisë, që kanë mundur të evitojnë incidentet e tilla.

Gjithashtu, ai theksoi se me organizim dhe planifikim më të mirë në zgjedhjet pasuese, incidentet e tilla do të evitohen. Duke kërkuar marrjen e masave adekuate për zgjedhjet e ardhshme, ai tha se rregullimi i situatës së tillë merr kohë dhe duhet qenë më tolerant, duke u shprehur gjithashtu se është koha e fundit që EULEX-i dhe Policia e Kosovës, të identifikojnë të gjithë ata që kanë bërë këto incidente dhe t'i sjellin para organeve të drejtësisë.

Ganimete Musliu – Tha se së pari duhet parë analizën e policisë për ditën e zgjedhjeve, derisa të ketë një raport të bazuar në organet kompetente të sigurisë në vend. Ajo përgëzoi qytetarët e veriut të Mitrovicës për gatishmërinë e tyre, për të marrë pjesë në zgjedhje dhe i inkurajoi ata që të mos zhgënjehen e të mos kenë frikë, ndërsa zgjedhjet e raundit tjetër të organizohen për pjesëmarrje më masive, sepse siç tha ajo, vetëm duke marrë pjesë në zgjedhje të lira dhe demokratike, ata do të jenë pjesë e shoqërisë dhe institucioneve të Kosovës. Gjithashtu, shprehu indinjatën e saj dhe dënoi aktin e sulmit ndaj selisë së Partisë Demokratike të Kosovës në veri, duke potencuar kështu se aktet e tilla dëmtojnë imazhin e Kosovës në përgjithësi, pavarësisht asaj se kush e ka bërë këtë.

Goran Marinković – Sa i përket pikës së rendit të ditës, është koha që Komisioni ta shqyrtojë këtë çështje. Ngjarjet në veri të Mitrovicës, nuk kanë qenë një befasi, sepse ka vite që në veri ka probleme. Konsideroj se zgjedhjet në atë pjesë është dashur të zhvillohen në mënyrë demokratike dhe të shihen rezultatet përfundimtare.

Organet kompetente duhet të merren me aktorët që kanë ndërhyrë dhe kanë penguar zhvillimin e procesit zgjedhor në qendrat e votimit, sepse për shkak të tyre, zgjedhjet duhet të përsëriten.

Edhe pse në veri është pritur të ketë tensione, gjithashtu edhe në jug ka pasur tensione, duke ushtruar presion tek votuesit, për të ndërruar realitetin politik në Kosovë.

Sa i përket punës së Policisë së Kosovës në ditën e zgjedhjeve në Graçanicë, nuk e ka kryer detyrën si duhet dhe se qytetarët e kësaj pjese nuk kanë mundur të llogarisin në Policinë e Kosovës, prandaj konsideroj se nga ana e tyre është dashur të kryhet detyra si duhet dhe si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës, duhet të mendojmë se si t'i mbrojmë ata.

Kryetari i Komisionit – Tha se duhet kërkuar një informatë nga Policia e Kosovës dhe EULEX-i, për të pasur një pasqyrë të qartë për zhvillimet që ndodhën në pjesën veriore gjatë zgjedhjeve, dhe po ashtu, rreth çështjeve të përmendura nga z.Marinković.

Ai theksoi se edhe në pjesën jugore ka pasur raste të ndikimeve, por këto ankesa duhet të bëhen nga komisionarët, vëzhguesit dhe pjesëmarrësit tjerë në procesit zgjedhor. Po ashtu, duke dënuar incidentet në veriun e Mitrovicës me rastin e zgjedhjeve, për moslënien e qytetarëve për të shprehur vullnetin e lirë dhe trysninë e ushtruar mbi ta, ndërsa u shpreh i kënaqur me vullnetin e treguar të një pjese të qytetarëve për të dalë në zgjedhje.

Gjithashtu, ai tha se Komisioni i dënon këto akte, duke theksuar se nuk duhet lejuar që personalitete nga shteti tjetër, të hyjnë dhe të influencojnë brenda territorit të Republikës së Kosovës, për të votuar vetëm një parti, sepse siç u shpreh ai, këtu ka demokraci dhe shtet. Më tutje, ai potencoi se nuk duhet lejuar që pa lejen e institucioneve të vendit të hyjnë personalitete të cilët e cenojnë demokracinë dhe kushtetutshmërinë e vendit dhe duhet të merren masa më të ashpra në këtë drejtim, duke porositur Policinë e Kosovës dhe EULEX-it, të jenë më të përgatitura që në zgjedhjet e 17 nëntorit, që të mos përsëriten ato që kanë ndodhur më 3 nëntor.

Rexhep Selimi – Kërkoj që para kërkesës së një raporti nga Policia e Kosovës dhe ajo e EULEX-it, të kërkohej një raport nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, ndërsa sa i përket EULEX-it, ai tha se nuk dihet se a do të ketë përgjigje nga ana e tyre, sepse siç u shpreh ai, EULEX-i nuk është nën mbikëqyrjen e Kuvendit, dhe në mandatin e tyre, nuk është përgjegjësi që t'i përgjigjen Kuvendit. Si përfundim, ai tha se fillimisht duhet kërkuar Raport nga MPB-ja dhe Drejtoria e Policisë së Kosovës, institucione të cilat i mbikëqyrë Kuvendi, ndërsa sa i përket EULEX-it, ai tha se një raport i tillë më tepër do të ishte simbolizues sesa obligues i tyre.

Kryetari i Komisionit – Tha se Komisioni do të kërkojë informatë dhe jo raport, duke theksuar se nëse përgjigjja e informatës nuk do të jetë ashtu siç është kërkuar e baraspeshuar dhe e plotë, dhe nëse Komisioni nuk pajtohet me një informatë të tillë, atëherë nga MPB-ja do të kërkohej një raport i detajuar. Ai gjithashtu theksoi se Komisioni ka të drejtë që nga EULEX-i të kërkojë informatë, dhe nëse informatat e ofruara nga MPB-ja, Policia e Kosovës dhe EULEX-i, vlerësohen si jo të plota apo me mangësi, atëherë të kërkohej raport nga MPB-ja.

Fatmir Xhelili – Tha se EULEX-i asnjëherë nuk ka refuzuar kërkesën e Komisionit për informata. Ai më tej potencoi se EULEX-i çdoherë është shprehur i gatshëm për bashkëpunim

me institucionet e Kosovës, duke theksuar se një gjë e tillë është në të mirë edhe të EULEX-it, si strukturë dhe si komponent në arritjen e rezultateve të pritshme. Gjithashtu, shtoi se ndonjëherë edhe segmentet më të përsosura dështojnë, duke u shprehur se dështimi në këtë rast, nuk ka qenë aq i madh.

Kryetari i Komisionit – Kërkoi nga MPB-ja dhe EULEX-i, që brenda mundësive, të ketë një informatë me të dhënat që ata posedojnë, para zgjedhjeve të raundit të dytë, konkretisht deri të mërkurën, më 13 nëntor.

Fatmir Xhelili – Kërkoi që të mos caktohet mbledhja para arritjes së përgjigjes nga ana e tyre, duke theksuar se kërkesa të bëhet me shkrim, sepse siç tha ai, ata nuk mund të përgjigjen në bazë të asaj se çfarë thuhet nga mjetet e informimit.

Kryetari i Komisionit – Tha se Komisioni çdoherë i drejton kërkesat e tij me shkrim, po ashtu edhe përgjigjet i merr të tilla, të cilën gjë do ta bëjë edhe në këtë rast me institucionet e përmendura, duke potencuar se duhet caktuar një afat i përgjigjeve, pasi që më 17 nëntor janë zgjedhjet dhe paraprakisht duhet pasur një informatë se çfarë ka ndodhur dhe cilat do të jenë veprimet e institucioneve të sigurisë, për të pasur zgjedhje normale.

Rexhep Selimi – Kërkoi përgjegjësi nga institucionet të cilat mbikëqyren nga Kuvendi, pavarësisht informatave të arritura nga secili institucion. Ai tha se nga MPB-ja dhe Policia e Kosovës, organe këto nën mbikëqyrjen e Komisionit, duhet kërkuar përgjegjësi dhe raport, ndërsa sa i përket informatës nga ana e EULEX-it, ai tha se një gjë e tillë duhet marrë parasysh se mund edhe të mos vijë.

Përveç përgjegjësisë, tha se duhet kërkuar edhe masat preventive nga institucionet tona të sigurisë, që me datën 17 të mos ndodhë asgjë e ngjashme, si dhe masat e sigurisë të jenë adekuate për rrethanat në të cilat do të zhvillohen këto zgjedhje, u shpreh ai, duke potencuar se bashkë me kërkesën për përgjegjësi, të ketë edhe një porosi shumë të prerë, që të ndërmerren masa të nevojshme që procesi zgjedhor të jetë i lirshëm dhe të mos prishen më nga banda dhe njerëz me akte kriminale.

Kryetari i Komisionit – Tha se së pari do të pranohen informatat, ndërsa mbledhja do të mbahet më 14 ose 15 nëntor, në mënyrë që për datën 17 nëntor, Komisioni të ketë rekomandimet e tij për institucionet e vendit dhe ato ndërkombëtare të sigurisë.

Rendi i ditës u miratua me këto ndryshime:

1. *Heqja nga rendi i ditës: Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;*
2. *Diskutimi rreth situatës për veriun e Kosovës, pas zgjedhjeve të 3 nëntorit.*

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 01.10.2013

Kryetari i Komisionit – Konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur, më 01.10.2013.

Procesverbalet u miratuan pa ndryshime.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – Njoftoi anëtarët e Komisionit për organizimin e një konference nga DCAF, më 13 nëntor, me temën: “*Integriteti policor dhe roli i kontrollit të policisë*”. Ai gjithashtu njoftoi anëtarët për përgatitjen e planit të punës së Komisionit për vitin e ardhshëm.

Danush Ademi – Kërkoj nga Komisioni që t’i bëjë një kërkesë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për një informatë rreth rastit për tentim vetëvrasje para kësaj Ministrie.

Kryetari i Komisionit – Lidhur me këtë, tha se Komisioni do të kërkojë një informatë nga kjo Ministri, ku 3 qytetarë kanë dashur të bëjnë vetëvrasje para kësaj Ministrie, pra duke dashur t’i vënë zjarrin vetes, si dhe për raste të tjera të ngjashme, duke theksuar se Komisioni do të kërkojë një informatë rreth këtyre ngjarjeve.

Me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi